



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe
Audiovizuele**
PA1 08-135
02.06.2026
Shkup



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk



Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe neni 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-135 datë 18.5.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-135 të datës 28.5.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-2261/3 datë 1.6.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 21-të, mbajtur më 1.6.2026, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TV Shenja ShPKNJ P Shkup, PA1 nr.08-778 datë 7.9.2023.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (ASHMA-së) në seancën e 18-të mbajtur më 20.5.2026, me Konkluzionin nr.ark.02-2165/2 datë 20.5.2026, miratoi propozimin e dr.Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-135 datë 18.5.2026, dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të TV Shenja ShPKNJ P Shkup, PA1 nr.08-778 datë 7.9.2023, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim nr.ark.05-2151/1 datë 15.5.2026, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të faturës së lëshuar nga ASHMA, nuk ka përmbushur detyrimin e nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV-së), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv ASHMA-së.

Në lidhje me këtë, nga ana e ASHMA-së më datë 21.5.2026, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-135 datë 21.5.2026, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv. Njoftimi më datë

¹ Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

21.5.2026 është dërguar dhe në mënyrë elektronike në e-mail adresën zyrtare të transmetuesit, regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV-së dhe në regjistrin e radiodifuzerëve që mbahet nga Agjencia.

Megjithatë, më 27.5.2026 nga Sektori për financa dhe logjistikë, drejtuar drejtorit të Agjencisë është dorëzuar Njoftimi me nr.ark.05-2151/2 datë 27.5.2026, se ShTR TV Shenja ShPKNJ P Shkup, më 21.5.2026, ka kryer pagesë në shumë prej 3.695.000,00 (tre milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) denarë dhe më datë 26.5.2026, ka kryer pagesë në shumë prej 334.334,00 (treqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e katër) denarë, me të cilën transmetuesi kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e pagoi plotësisht.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe neni 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-135 datë 18.5.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-135 datë 28.5.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-2261/3 datë 1.6.2026, Këshilli i Agjencisë në seancën e 21-të mbajtur më 1.6.2026, vendosi ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.